<p>të përcaktuara në nenin 5 dhe 6 të këtij ligji.;</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Kategorizimi sipas të ardhurave</b></p> <p>1. Familja apo individit sipas nivelit të të ardhurave mujore kategorizohen si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1.Kategoria e parë (I) të varfër ekstrem;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2.Kategoria e dytë (II) të varfër;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3.Kategoria e tretë (III) me të ardhura të ulëta;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Kategoria e katërt (IV) me të ardhura mesatare.</p> <p>2. Përcaktimi i kategorisë nga paragrafi 1, i këtij neni bëhet përmes verifikimit dhe zbatimit të testit të varfërisë, bazuar në kriteret e OBZHE/OECD.</p> <p>3. Ministria me akt nënligjor përcakton kategorinë e familjes apo individit dhe kriteret që ata duhet t'i përmbushin për të përfituar nga programet e banimit.</p>	<p>defined in article 5 and 6 of this law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Categorization according to income</b></p> <p>1. The family or individual is categorized according to the level of monthly incomes as follows:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. First category (I), extreme poor;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Second category (II), poor;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. The third category (III), with low incomes;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Fourth category (IV), with average incomes.</p> <p>2. The definition of the category from paragraph 1, of this article, is done through the verification and application of the poverty test, based on the criteria of OECD.</p> <p>3. The Ministry by sub-legal act determines the category of the family or individual and the criteria they must fulfill in order to benefit from the housing programs.</p>	<p>definisanim u članu 5. i 6. ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Kategorizacija prema prihodima</b></p> <p>1. Porodica ili pojedinac se kategorišu prema visini mesečnih primanja na sledeći način:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Prva kategorija (I) ekstremno siromašni;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Druga kategorija (II) siromašni;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Treća kategorija (III) sa niskim primanjima;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Četvrta kategorija (IV) sa prosečnim primanjima.</p> <p>2. Definisanje kategorije iz stava 1. ovog člana vrši se verifikacijom i primenom testa siromaštva, na osnovu kriterijuma OSRE/OECD.</p> <p>3. Ministarstvo podzakonskim aktom definiše kategoriju porodice ili pojedinca i kriterijume koje moraju ispuniti da bi koristili programe stanovanja.</p>
--	---	---



<p align="center"><b>Neni 10</b> <b>Procedurat e aplikimit dhe përzgjedhjes</b></p>	<p align="center"><b>Article 10</b> <b>Application and selection procedures</b></p>	<p align="center"><b>Član 10</b> <b>Procedure prijave i selekcije</b></p>
<p>1. Komuna, bazuar në disponueshmërinë e stokut të njërive të banimit shpall thirrje publike për programet e banimit, derisa aplikimi për t'u përfshirë në regjistër bëhet gjatë tërë vitit.</p> <p>2. Komuna, përmes thirrjes publike përcakton kriteret e përfitimit, procedurat dhe mënyrën e aplikimit dhe afatet për programet e banimit social.</p> <p>3. Aplikimi fillon me paraqitjen e kërkesës, sipas formës standarde të ofruar nga komuna e vendbanimit të aplikuesit.</p> <p>4. Procedurat e aplikimit janë transparente, të hapura dhe mundësojnë aplikimin e çdo familje apo individi që i plotëson kriteret e parapara me këtë ligj.</p> <p>5. Komuna ofron mbështetje për plotësimin e aplikacionit, pa kosto administrative.</p> <p>6. Komuna publikon në web faqen e saj informacionet lidhur me procedurat e aplikimit.</p>	<p>1. The municipality, based on the availability of the stock of housing units, shall announce a public call for housing programs, while the application to be included in the register is made throughout the year.</p> <p>2. The municipality, through a public call, shall set the benefit criteria, the procedures and application method and the time limits for social housing programs.</p> <p>3. The application commences upon the submission of the application, according to the standard form provided by the municipality of the applicant's residence.</p> <p>4. The application procedures shall be transparent, open and enable the application of any family or individual that meets the criteria provided for by this law.</p> <p>5. The municipality shall offer support for filling out the application, without administrative costs.</p> <p>6. The municipality shall publish on its website the information related to the application procedures.</p>	<p>1. Opština, na osnovu raspoloživosti stoka stambenih jedinica, raspisuje javni poziv za programe stanovanja, a prijava za upis u registar se vrši tokom cele godine.</p> <p>2. Opština putem javnog poziva utvrđuje kriterijume beneficija, procedure i način prijave i rokove za programe socijalnog stanovanja.</p> <p>3. Prijava počinje podnošenjem zahteva, prema standardnom obrascu koji obezbeđuje opština prebivališta podnosioca.</p> <p>4. Procedure prijave su transparentne, otvorene i omogućavaju prijavu svake porodice ili pojedinca koji ispunjava kriterijume predviđene ovim zakonom.</p> <p>5. Opština nudi podršku za popunjavanje aplikacije, bez administrativnih troškova.</p> <p>6. Opština na svojoj internet stranici objavljuje informacije u vezi sa procedurama prijavljivanja.</p>

<p>7. Kryetari i Komunës emëron Komisionin vlerësues për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve të programeve të banimit, prej pesë (5) anëtarëve me mandat tre (3) vjeçar, i cili duhet të ketë përfaqësim gjinor, komunitetit jo shumicë dhe anëtarë nga shoqëria civile;</p> <p>8. Me propozim të Ministrisë, Qeveria, me akt nënligjor, përcakton përmbajtjen e shpalljes së thirrjeve publike, kriteret e përfitimit, dokumentacionin e nevojshëm, procedurën e aplikimit, vlerësimin dhe përzgjedhjes, si dhe punën e Komisionit vlerësues.</p>	<p>7. The Mayor of the Municipality shall appoint the Evaluation Commission for the evaluation and selection of the beneficiaries of housing programs, of five (5) members with a three (3) year mandate, which must have representation of gender, the non-majority community and members from civil society;</p> <p>8. At the proposal of the Ministry, the Government, by means of a sub-legal act, shall set the content of the announcement of public calls, the benefit criteria, the necessary documentation, the application, evaluation and selection procedure, as well as the work of the Evaluation Commission.</p>	<p>7. Predsednik opštine imenuje Komisiju za ocenjivanje i izbor korisnika stambenih programa, od pet (5) članova sa mandatom od tri (3) godine, koja mora imati polnu zastupljenost, nevećinsku zajednicu i članovi civilnog društva;</p> <p>8. Vlada, na predlog Ministarstva, podzakonskim aktom utvrđuje sadržinu raspisivanja javnih poziva, kriterijume pogodnosti, potrebnu dokumentaciju, postupak prijave, ocenjivanja i izbora, kao i rad Komisije za ocenjivanje.</p>
<p><b>Neni 11</b> <b>Llojet e programeve të banimit</b></p>	<p><b>Article 11</b> <b>Types of housing programs</b></p>	<p><b>Član 11</b> <b>Vrste programa za stanovanje</b></p>
<p>1. Me llojet e programeve të banimit për qëllime të këtij ligji, kuptojmë:</p> <p>1.1. Programi për banim social;</p> <p>1.2. Programi për zhvillimin e lagjeve adekuate;</p> <p>1.3. Programi për rindërtimin apo renovimin e shtëpive;</p> <p>1.4. Programi për banim të përbalueshëm; dhe</p>	<p>1. By the types of housing programs for the purposes of this law, it is meant:</p> <p>1.1. Program for social housing;</p> <p>1.2. Program for the development of adequate neighborhoods;</p> <p>1.3. Program for reconstruction or renovation of houses;</p> <p>1.4. Program for affordable housing; and</p>	<p>1. Pod vrstama stambenih programa za potrebe ovog zakona podrazumevamo:</p> <p>1.1. Program socijalnog stanovanja;</p> <p>1.2. Program razvoja adekvatnih mahala (kvartova);</p> <p>1.3. Program rekonstrukcije ili renoviranja kuća;</p> <p>1.4. Program za pristupačno stanovanje; i</p>

<p>1.5. Programe të tjera të lidhura me planifikimin e banimit dhe urbanizimin, që konsiderohen me interes publik, të përcaktuara nga autoritetet përgjegjëse.</p> <p><b>KAPITULLI III PROGRAMI PËR BANIM SOCIAL</b></p> <p><b>Neni 12 Kushtet e përgjithshme të programit për banim social</b></p> <p>1. Programi për banim social siguron banim me qira jofitimprurëse për familjet apo individët të ardhurat e të cilave janë të pa mjaftueshme, për të mbuluar koston e banimit sipas kushteve dhe kriterëve të këtij ligji.</p> <p>2. Programi për banim social realizohet përmes:</p> <p>2.1. Ofrimit me qira jofitimprurëse të njësive të banimit në pronësi të komunës, apo të ndonjë entiteti tjetër publik të cilat menaxhohen nga komuna apo përmes ndonjë autoriteti tjetër publik; dhe</p> <p>2.2. Subvencionimit të qirasë së banimit për familjet apo individët përfitues në njësitë e banimit në pronësi private.</p>	<p>1.5. Other programs related to housing planning and urbanization, which are considered to be of public interest, determined by the responsible authorities.</p> <p><b>CHAPTER III SOCIAL HOUSING PROGRAM</b></p> <p><b>Article 12 General conditions of the Social Housing Program</b></p> <p>1. The Social Housing Program shall provide non-profit rental housing for families or individuals whose income is insufficient to cover the cost of housing according to the conditions and criteria of this law.</p> <p>2. Social Housing Program shall be realized through:</p> <p>2.1. Providing non-profit rental housing units owned by the municipality, or any other public entity which are managed by the municipality or through any other public authority; and</p> <p>2.2. Housing rent subsidy for beneficiary families or individuals in privately owned housing units.</p>	<p>1.5. Ostali programi koji se odnose na planiranje stanovanja i urbanizaciju, koji se smatraju od javnog interesa, utvrđuju nadležni organi.</p> <p><b>POGLAVLJE III PROGRAM SOCIJALNOG STANOVANJA</b></p> <p><b>Član 12 Opšti uslovi programa socijalnog stanovanja</b></p> <p>1. Programom socijalnog stanovanja obezbeđuje se neprofitno stanovanje pod zakup porodicama ili pojedincima čiji prihodi nisu dovoljni da pokriju troškove stanovanja prema uslovima i kriterijumima ovog zakona.</p> <p>2. Program socijalnog stanovanja realizuje se kroz:</p> <p>2.1. Obezbeđivanje neprofitnih stambenih jedinica za iznajmljivanje u vlasništvu opštine, ili bilo kog drugog javnog entiteta kojim upravlja opština ili preko bilo kog drugog javnog organa; i</p> <p>2.2. Subvencija za zakup za porodice ili pojedince korisnika u stambenim jedinicama u privatnom vlasništvu.</p>
---	--	--

<p align="center"><b>Neni 13</b> <b>Stoku i njësive të banimit social</b></p>	<p align="center"><b>Article 13</b> <b>Stock of social housing units</b></p>	<p align="center"><b>Član 13</b> <b>Stok socijalnih stambenih jedinica</b></p>
<p>1. Komuna ka në pronësi, krijon dhe zgjeron stokun e njësive të banimit social përmes:</p> <p>1.1. Renovimit të ndërtesave dhe njësive ekzistuese të banimit social;</p> <p>1.2. Shndërrimit të ndërtesave të vjetra apo strukturave ekzistuese në ndërtesa të banimit social;</p> <p>1.3. Ndërtimit të ndërtesave të reja për banim social nga komuna, qeveria apo donatorët;</p> <p>1.4. Blerjes me kushte të favorshme në treg, të ndërtesave apo njësive të banimit me qëllim të përdorimit për banim social;</p> <p>1.5. Ndërtimit të njësive të banimit social nga subjektet publike apo private ose partneritetit publiko-privat, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi; dhe</p> <p>1.6. Përmes kontratës së dhurimit të parapara me ligj, përmes së cilës komunës i lejohet kalimi i të drejtave pronësore në njësi të banimit, përfshirë pronësinë mbi pronat e konfiskuara sipas legjislacionit në</p>	<p>1. The municipality shall have under its ownership, shall create and expands the stock of social housing units through:</p> <p>1.1. Renovation of the existing social housing buildings and units;</p> <p>1.2. Conversion of old buildings or the existing structures into social housing buildings;</p> <p>1.3. Construction of new buildings for social housing by the municipality, the government or donors;</p> <p>1.4. Purchase of buildings or housing units with favorable conditions in the market for the purpose of use for social housing;</p> <p>1.5. Construction of social housing units by public or private entities or public-private partnerships, according to the provisions of the legislation in force; and</p> <p>1.6. Through the donation contract provided for by law, whereby the municipality is permitted to be transferred to the property rights in housing units, including ownership of properties confiscated according to the</p>	<p>1. Opština poseduje, stvara i proširuje fond socijalnih stambenih jedinica kroz:</p> <p>1.1. Renoviranje postojećih zgrada i jedinica socijalnog stanovanja;</p> <p>1.2. Pretvaranje starih zgrada ili postojećih objekata u zgrade socijalnog stanovanja;</p> <p>1.3. Izgradnja novih zgrada za socijalno stanovanje od strane opštine, vlade ili donatora;</p> <p>1.4. Kupovina objekata ili stambenih jedinica sa povoljnim uslovima na tržištu radi korišćenja za socijalno stanovanje;</p> <p>1.5. Izgradnja socijalnih stambenih jedinica od strane javnih ili privatnih subjekata ili javno-privatnog partnerstva, u skladu sa odredbama važećeg zakonodavstva; I</p> <p>1.6. Zakonom predviđenim ugovorom o donaciji, kojim se opštini dozvoljava prenos imovinskih prava u stambenim jedinicama, uključujući vlasništvo nad oduzetom imovinom u skladu sa zakonima na snazi.</p>

<p>fuqi.</p> <p>2. Krijimi dhe zgjerimi i stokut të njësive të banimit social, bazohet në kriteret e përshtatshmërisë së lokacionit, planifikimit hapësinor, Planit dhe Profilit të banimit të Komunës, të përcaktuara me dispozitat e nenit 30 dhe 32 të këtij ligji.</p> <p>3. Krijimi dhe rritja e stokut të njësive të banimit social financohet nga komuna, mjetet nga granti i përgjithshëm, financimit nga Ministria, donatorët, si dhe institucionet financiare vendore dhe ndërkombëtare.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave dhe njësive të banimit social</b></p> <p>1. Ndërtesat e banimit social të ndërtuara me financim të buxhetit të Republikës së Kosovës ose fondeve tjera, barten në pronësi të komunës në territorin e së cilës janë të ndërtuara.</p> <p>2. Ndërtesat e banimit social administrohen dhe mirëmbahen nga organi përgjegjës i komunës.</p> <p>3. Komunitat kanë të drejtë të bartin të drejtat e administrimit tek subjektet tjera publike apo private, duke përfshirë, ndërmarrjet publike,</p>	<p>legislation in force.</p> <p>2. Creation and expansion of the stock of social housing units is based on the criteria of suitability of the location, spatial planning, Housing Plan and Profile of the Municipality, stipulated by the provisions of Article 30 and 32 of this law.</p> <p>3. Creation and increase of the stock of social housing units shall be financed by the municipality, funds from the general grant, financing from the Ministry, donors, as well as local and international financial institutions.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Administration and maintenance of social housing buildings and units</b></p> <p>1. Social housing buildings built with financing from the budget of the Republic of Kosovo or other funds shall be transferred under the ownership of the municipality in whose territory they are built.</p> <p>2. Social housing buildings shall be administered and maintained by the responsible body of the municipality.</p> <p>3. Municipalities have the right to transfer administration rights to other public or private entities, including public enterprises,</p>	<p>2. Stvaranje i proširenje stoka jedinica socijalnog stanovanja zasniva se na kriterijumima podobnosti lokacije, prostornog planiranja, plana i stambenog profila opštine, utvrđenih odredbama člana 30. i 32. ovog zakona.</p> <p>3. Stvaranje i povećanje stoka jedinica socijalnog stanovanja finansira opština, sredstvima opšteg granta, finansiranjem Ministarstva, donatora, kao i domaćih i međunarodnih finansijskih institucija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Upravljanje i održavanje zgrada i jedinica socijalnog stanovanja</b></p> <p>1. Zgrade socijalnog stanovanja izgrađene sredstvima iz budžeta Republike Kosovo ili drugih fondova su u vlasništvu opštine na čijoj teritoriji su izgrađene..</p> <p>2. Zgradama socijalnog stanovanja upravlja i održava nadležni organ opštine.</p> <p>3. Opštine imaju pravo da prenesu administrativna prava na druge javne ili privatne subjekte, uključujući javna preduzeća,</p>
---	--	--

<p>shoqëritë tregtare, OJQ-të dhe subjektet me status të ndërmarrjes sociale.</p> <p>4. Bartja e të drejtave nga Komuna tek subjektet tjera, nuk krijon barrë financiare apo administrative për përfituesin.</p> <p>5. Mjetet e grumbulluara nga qiraja jofitimprurëse përdoren për të mbuluar shpenzimet e administrimit dhe mirëmbajtjes, së rregullt të ndërtesës së banimit social, apo ndërtesës në të cilën ndodhet njësia e banimit social.</p> <p>6. Administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të banimit social bëhet sipas ligjit përkatës.</p>	<p>commercial companies, NGOs and entities with social enterprise status.</p> <p>4. The transfer of rights from the Municipality to other entities does not create a financial or administrative burden for the beneficiary.</p> <p>5. Funds collected from the non-profit rent are used to cover the costs of regular administration and maintenance of the social housing building, or the building in which the social housing unit is located.</p> <p>6. The administration and maintenance of social housing buildings shall be done pursuant to the relevant law.</p>	<p>komercijalna preduzeća, NVO i subjekte sa statusom socijalnog preduzeća.</p> <p>4. Prenos prava sa opštine na druge subjekte ne stvara finansijsko ili administrativno opterećenje za korisnika.</p> <p>5. Sredstva prikupljena od neprofitne zakupnine koriste se za pokrivanje troškova redovne administracije i održavanja zgrade socijalnog stanovanja, odnosno zgrade u kojoj se nalazi jedinica socijalnog stanovanja.</p> <p>6. Upravljanje i održavanje zgrada socijalnog stanovanja vrši se u skladu sa relevantnim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Kriteret për shpërndarjen e njësive të banimit social</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Criteria for the allocation of social housing units</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Kriterijumi za raspodelu jedinica socijalnog stanovanja</b></p>
<p>1. Shpërndarja e njësive të banimit social në kuadër të projekteve të banimit social sipas kategorive të përfituesve të klasifikuara sipas të ardhurave, është si në vijim:</p> <p>1.1. Kategoria e parë (I) të varfër ekstrem;</p> <p>1.2. Kategoria e dytë (II) të varfër;</p> <p>1.3. Kategoria e tretë (III) me të ardhura të ulëta;</p>	<p>1. Allocation of social housing units within social housing projects by categories of beneficiaries classified by income, is as follows:</p> <p>1.1. The first category (I) extremely poor;</p> <p>1.2. The second category (II) poor;</p> <p>1.3. The third category (III) with low income;</p>	<p>1. Raspodela socijalnih stambenih jedinica u okviru projekata socijalnog stanovanja prema kategorijama korisnika razvrstanih prema prihodima je sledeća:</p> <p>1.1. Prva kategorija (I) ekstremno siromašni;</p> <p>1.2. Druga kategorija (II) siromašni;</p> <p>1.3. Treća kategorija (III) sa niskim primanjima;</p>

<p>1.4. Kategoria e katërt (IV) me të ardhura mesatare.</p> <p>2. Në qoftë se për njëri nga kategoritë në paragrafin 1, të këtij neni, nuk plotësohet kuota, pjesa e mbetur nga ajo kategori rikaptohet në mënyrë proporcionale tek kategoritë e mbetura.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Subvencionimi i qirasë jofitimprurëse</b></p> <p>1. Komuna lidh kontratë qiraje jofitimprurëse me përfituesin, për shfrytëzimin e njësisë të banimit social në pronësi të komunës, apo të ndonjë subjekti tjetër publik që menaxhohet nga komuna, ndonjë subjekti publiko privat apo nga burime tjera.</p> <p>2. Forma e kontratës për qiranë e lidhur në mes të komunës dhe përfituesit rregullohet në bazë të Ligjit përkatës për Marrëdhëniet e Detyrimeve.</p> <p>3. Komuna subvencionon pjesën e qirasë jofitimprurëse që kërkohet me kontratë.</p> <p>4. Njësia e banimit social jepet me qira jofitimprurëse nga komuna për një periudhë jo më pak se një (1) vit, dhe jo më shumë se pesë</p>	<p>1.4. The fourth category (IV) with average income.</p> <p>2. If for one of the categories in paragraph 1, of this article, the quota is not filled, the remaining part from that category is re-assigned proportionally to the remaining categories.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Subsidy of non-profit rent</b></p> <p>1.The municipality shall conclude a non-profit rental contract with the beneficiary, for the use of the social housing unit owned by the municipality, or any other public entity managed by the municipality, any private public entity or from other sources.</p> <p>2.The form of the lease contract concluded between the municipality and the beneficiary shall be regulated on the basis of the relevant Law on Obligational Relationships.</p> <p>3.The municipality shall subsidize the part of the non-profit rent that is required by contract.</p> <p>4. The social housing unit is leased on a non-profit basis by the municipality for a period of not less than one (1) year, and not more than</p>	<p>1.4. Četvrta kategorija (IV) sa prosečnim primanjima.</p> <p>2. Ako za jednu od kategorija iz stava 1. ovog člana kvota nije ispunjena, preostali deo iz te kategorije se preraspoređuje srazmerno ostalim kategorijama.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Subvencija za neprofitabilni zakup</b></p> <p>1.Opština zaključuje ugovor o neprofitnom zakupu sa korisnikom, za korišćenje jedinice socijalnog stanovanja u vlasništvu opštine, ili bilo kog drugog javnog subjekta kojim upravlja opština, bilo kojeg privatnog javnog subjekta ili iz drugih izvora.</p> <p>2.Oblik ugovora o zakupu koji se zaključuje između opštine i korisnika uređuje se na osnovu odgovarajućeg Zakona o obligacionim odnosima.</p> <p>3.Opština subvencionise deo neprofitabilnog zakupa koji je propisan ugovorom.</p> <p>4.Jedinicu socijalnog stanovanja opština daje u neprofitni zakup na period ne kraći od jedne (1) godine, a ne duži od pet (5) godina, sa</p>
--	---	--

<p>(5) vite, me mundësi vazhdimi pas vlerësimit të gjendjes ekonomike të shfrytëzuesit.</p> <p>5. Qiramarrësi përfitues do të paguajë qiranë e vlerësuar të përballeshme, sipas neneve 7 dhe 8, të këtij ligji,</p> <p>6. Subvencionimi i qirasë për përfituesit nga paragrafi 3, i këtij neni, bëhet nga Buxheti i Komunës, i aprovuar nga Kuvendi Komunal.</p> <p>7. Qiramarrësi e paguan çdo shpenzim tjetër që krijohet gjatë shfrytëzimit të njësisë së banimit.</p> <p>8. Organi përgjegjës komunal në bashkëpunim me qendrën për punë sociale e bën vlerësimin vjetor të gjendjes ekonomike të përfituesit, përmes verifikimit të të hyrave të llogaritshme dhe jo të llogaritshme të familjes apo zbatimin e testit të varfërisë, bazuar në legjislacionin në fuqi.</p> <p>9. Të dhënat nga vlerësimi përfshihen në platformën elektronike qendrore dhe të qasshme për komunat.</p> <p>10. Ministria me akt nënligjor përcakton menaxhimin e stokut të njësisë të banimit social, kriteret e përcaktimit të qirasë jofitimprurëse, vlerën e qirasë, procedurat e</p>	<p>five (5) years, with the possibility of extension after assessing the user's economic status.</p> <p>5. The beneficiary lessee will pay the estimated affordable rent, according to Articles 7 and 8 of this law.</p> <p>6. Rent subsidy for beneficiaries from paragraph 3 of this Article shall be made from the Municipal Budget, approved by the Municipal Assembly.</p> <p>7. The lessee shall pay any other expenses incurred during the use of the housing unit.</p> <p>8. The responsible municipal body in cooperation with the Center for Social Affairs shall make the annual assessment of the beneficiary's economic status, through the verification of the calculable and non-calculable incomes of the family or the application of the poverty test, based on the legislation in force.</p> <p>9. Data from the evaluation shall be inserted in the central electronic platform accessible to the municipalities.</p> <p>10. Ministry, by means of a sub-legal act, shall determine the management of the stock of social housing units, the criteria for setting the non-profit rent, the value of the rent, the</p>	<p>mogućnošću produženja nakon procene ekonomskog stanja korisnika.</p> <p>5. Zakupac će platiti pristupačni zakup, u skladu sa članovima 7 i 8 ovog zakona.</p> <p>6. Subvencionisanje zakupnine za korisnike iz stava 3. ovog člana vrši se iz budžeta opštine, odobrenog od strane Skupštine opštine.</p> <p>7. Zakupac plaća sve druge troškove nastale tokom korišćenja stambene jedinice.</p> <p>8. Nadležni opštinski organ u saradnji sa centrom za socijalni rad vrši godišnju procenu ekonomske situacije korisnika, kroz proveru obračunativih i neobračunljivih prihoda porodice ili sprovođenje testa siromaštva, na osnovu zakonodavstva na snazi.</p> <p>9. Podaci iz procene uključeni su u centralnu elektronsku platformu koja je dostupna opštinama.</p> <p>10. Ministarstvo podzakonskim aktom utvrđuje upravljanje stokom jedinica socijalnog stanovanja, kriterijume za određivanje neprofitabilne zakupnine, vrednost zakupnine,</p>
--	---	---



<p>mbledhjes dhe menaxhimit të qirasë, subvencionimin e qirasë jo fitimprurëse dhe subvencionimin e banimit në njësitë e banimit privat.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Subvencionimi i qirasë në njësinë e banimit privat</b></p> <p>1. Komuna lejon subvencionimin e qirasë në njësinë e banimit privat, për shfrytëzim nga familjet apo individët që i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj.</p> <p>2. Komuna, sipas paragrafit 1, të këtij neni, subvencionon pjesën në mes qirasë se tregut dhe aftësisë së përfituesit për të paguar, siç përcaktohet nga nenet 6 dhe 7 të këtij ligji.</p> <p>3. Subvencionimi i qirasë në njësitë e banimit privat aprovohet në Kuvendin e Komunës, varësisht nga buxheti i caktuar vjetor.</p> <p>4. Komuna, për çdo vit bazuar në të dhënat e vitit paraprak cakton shumën maksimale të subvencionimit të qirasë të kontraktuar në njësitë e banimit privat, që miratohet me vendim të Kuvendit të Komunës.</p> <p>5. Përfituesi i subvencionimit të qirasë në njësitë e banimit privat, lidh kontratë qiraje me</p>	<p>procedures for collecting and managing the rent, subsidizing non-profit rent and subsidizing housing in private housing units.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>Rent subsidy in a private housing unit</b></p> <p>1.The municipality shall permit rent subsidies in a private housing unit, for use by families or individuals who meet the general conditions and criteria defined in this law.</p> <p>2.The municipality, pursuant to paragraph 1 of this Article, shall subsidize the part between the market rent and the beneficiary’s ability to pay, as stipulated by Articles 6 and 7 of this law.</p> <p>3.Rent subsidy in private housing units shall be approved by the Municipal Assembly, depending on the annual budget.</p> <p>4. The Municipality, for each year, based on the data of the previous year, shall set the maximum amount of rent subsidy contracted in private housing units, which shall be approved by a decision of the Municipal Assembly.</p> <p>5. The beneficiary of the rent subsidy in private housing units, enters into a lease contract with</p>	<p>postupke naplate i upravljanja zakupninom, subvencionisanje neprofitabilne zakupnine i subvencionisanje stanovanja u privatnim stambenim jedinicama.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Subvencija za zakup u privatnoj stambenoj jedinici</b></p> <p>1.Opština dozvoljava subvencije zakupnine u privatnim stambenim jedinicama, za korišćenje porodicama ili pojedincima koji ispunjavaju opšte uslove i kriterijume definisane ovim zakonom.</p> <p>2. Opština, u skladu sa stavom 1. ovog člana, subvencionise deo između tržišne zakupnine i sposobnosti korisnika da plati, kao što je utvrđeno članovima 6. i 7. ovog zakona.</p> <p>3. Subvencionisanje zakupnine u privatnim stambenim jedinicama odobrava Skupština opštine, u zavisnosti od godišnjeg budžeta.</p> <p>4. Opština za svaku godinu, na osnovu podataka iz prethodne godine, utvrđuje maksimalan iznos ugovorene subvencije zakupnine u privatnim stambenim jedinicama, koji se odlukom Skupštine opštine odobrava.</p> <p>5.Korisnik subvencije za zakup u privatnim stambenim jedinicama, zaključuje ugovor o</p>
---	--	--

<p>organin përgjegjës të komunës brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e marrjes së vendimit nga Kuvendi i Komunës.</p> <p>6. Komuna bën vlerësimin vjetor dhe rishqyrton të drejtën e përfitimit të subvencionimit të qirasë së banimit në njësitë e banimit privat.</p> <p>7. Subvencioni nga komuna është pesëdhjetë përqind (50%) të qirasë për banimin në njësitë e banimit privat.</p>	<p>the responsible body of the municipality within thirty (30) days from the date of receipt of the decision by the Municipal Assembly.</p> <p>6. The municipality shall make an annual assessment and shall re-examine the right to benefit from housing rent subsidies in private housing units.</p> <p>7. The subsidy from the municipality is fifty percent (50%) of the rent for living in private housing units.</p>	<p>zakupu sa nadležnim organom opštine u roku od trideset (30) dana od dana donošenja odluke Skupštine opštine.</p> <p>6. Opština vrši godišnju procenu i preispituje pravo na subvenciju za stanarinu u privatnim stambenim jedinicama.</p> <p>7. Subvencija opštine iznosi pedeset odsto (50%) zakupnine za život u privatnim stambenim jedinicama.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 18</b> <b>Shkëputja e kontratës</b></p> <p>1. Komuna, apo organi përgjegjës i Komunës dhe përfituesi në mënyrë të vullnetshme e ndërpresin kontratën e qirasë, në momentin kur pushon nevoja për banim apo është zgjidhur çështja e banimit në forma tjera.</p> <p>2. Organi përgjegjës i Komunës e shkëput në mënyrë të njëanshme kontratën e qirasë, kontratën për subvencionimin e qirasë jo fitimprurëse dhe kontratën për subvencionim të qirasë në njësitë e banimit privat në rastet kur qiramarrësi:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. Ka bërë deklaram të rrejshëm për të hyrat;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 18</b> <b>Termination of the contract</b></p> <p>1. The Municipality, or the responsible body of the Municipality and the beneficiary, voluntarily terminate the lease contract, at the moment when the need for housing ceases, or the issue of housing has been resolved in other forms.</p> <p>2. The responsible body of the Municipality unilaterally disconnects the lease contract, the contract for subsidizing non-profitable rent and the contract for subsidizing rent in private housing units, in cases where the tenant:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. Has made a false declaration about incomes;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 18</b> <b>Raskid ugovora</b></p> <p>1. Opština, odnosno nadležni organ opštine i korisnik dobrovoljno raskinu ugovor o zakupu, u trenutku kada prestane potreba za stanovanjem ili je pitanje stanovanja rešeno u drugim oblicima.</p> <p>2. Nadležni organ opštine jednostrano raskine ugovor o zakupu, ugovor o subvencionisanju neprofitabilne zakupnine i ugovor o subvencionisanju zakupnine u privatnim stambenim jedinicama u slučajevima kada zakupac:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. Dao je lažnu izjavu o prihodima;</p>

<p>2.2. Ka zgjidhur çështjen e banimit dhe nuk ka njoftuar organin përgjegjës të komunës;</p> <p>2.3. I ka dhënë palës së tretë banesën me nën qira;</p> <p>2.4. Nuk ka shfrytëzuar banesën në periudhën prej tridhjetë (30) ditësh, pa arsyetim;</p> <p>2.5. Nuk ka përmbushë kriteret e përfitimit për banim social, sipas neneve 6 deri 9 të këtij ligji; dhe</p> <p>2.6. Në rastet tjera të përcaktuara në kontratën për subvencionim të qirasë në njësitë e banimit privat.</p> <p>3. Përjashtimisht nga rregullat e përcaktuara në paragrafin 2, nën paragrafin 2.5, të këtij neni, në rastet të veçanta në kuadër të rivlerësimit të gjendjes ekonomike siç përcaktohet në nenin 16 të këtij ligji, nëse familja apo individ nuk ri kualifikohet për kategoritë e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, Kuvendi i Komunës ish përfituesit i cili paraprakisht i ka kryer të gjitha obligimet sipas kontratës, ia vazhdon kontratës duke aplikuar rritje të pagesës së qirasë në vlerë prej të paktën dhjetë përqind (10%) mbi vlerën</p>	<p>2.2. Has resolved the housing issue and has not notified the responsible body of the municipality;</p> <p>2.3. Has sublet the apartment to a third party;</p> <p>2.4. Has not used the apartment in the period of thirty (30) days, without justification;</p> <p>2.5. It has not fulfilled the criteria of benefit for social housing, according to articles 6 to 9 of this law; and</p> <p>2.6. In other cases, defined in the contract for rent subsidy in private residential units.</p> <p>3. Except from the rules defined in paragraph 2, sub-paragraph 2.5, of this article, in special cases within the reassessment of the economic situation as defined in article 16 of this law, if the family or individual does not requalify for the categories defined in the article 7 of this law, the Municipal Assembly of the former beneficiary, who previously fulfilled all obligations under the contract, continues the contract by applying an increase in the rent payment in the amount of at least ten percent</p>	<p>2.2. Rešio stambeno pitanje i nije obavestio nadležni organ opštine;</p> <p>2.3. Stan je dao trećem licu u podzakup;</p> <p>2.4. Ne koristi stan u periodu od trideset (30) dana, bez opravdanja;</p> <p>2.5. Nije ispunio kriterijume za socijalno stanovanje, prema članovima 6 do 9 ovog zakona; i</p> <p>2.6. U drugim slučajevima definisanim ugovorom o subvenciji zakupnine u privatnim stambenim jedinicama.</p> <p>3. Izuzev pravila definisanih u stavu 2, prema stavu 2.5 ovog člana, u posebnim slučajevima u okviru ponovne procene ekonomske situacije kao što je definisano u članu 16 ovog zakona, ako se porodica ili pojedinac ne kvalifikuju za definisane kategorije u članu 7. ovog zakona, Skupština opštine bivšeg korisnika, koji je prethodno ispunio sve obaveze po ugovoru, nastavlja ugovor primenom povećanja zakupnine u iznosu od najmanje deset odsto (10%) iznad najveće vrednosti procenjenog</p>
--	--	--

<p>më të lartë të qirasë së vlerësuar të tregut dhe qirasë jofitimprurëse.</p> <p>4. Pas shkëputjes së njëanshme të kontratës sipas paragrafit 1, të këtij neni, qiramarrësi njoftohet me shkrim që në afat prej tridhjetë (30) ditëve, ta liroj vullnetarisht njësinë e banimit, në të kundërtën organi përgjegjës i komunës bën largimin e detyrueshëm nga njësia e banimit.</p> <p>5. Shkëputja e kontratës së qirasë bëhet edhe nga ana e qiramarrësit, me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.</p> <p>6. Qiramarrësi ka për obligim që të shlyej çdo detyrim nga shfrytëzimi i njësisë së banimit dhe shërbimeve përcjellëse para shkëputjes së kontratës.</p>	<p>(10%) above the highest value of estimated market rent and unprofitable rent.</p> <p>4. After the unilateral termination of the contract according to paragraph 1, of this article, the tenant is notified in writing that within a period of thirty (30) days, he must voluntarily vacate the housing unit, otherwise the responsible body of the municipality makes the mandatory removal from the housing unit.</p> <p>5. Termination of the lease contract is also done by the lessee, with a prior notice of thirty (30) days.</p> <p>6. The tenant has the obligation to pay off any obligation from the use of the housing unit and accompanying services before terminating the contract.</p>	<p>tržišnog zakupa i neprofitabilnog zakupa.</p> <p>4. Nakon jednostranog raskida ugovora iz stava 1. ovog člana, zakupac se pismeno obaveštava da u roku od trideset (30) dana mora dobrovoljno da napusti stambenu jedinicu, u suprotnom nadležni organ opštine izvrši obavezno uklanjanje iz stambene jedinice.</p> <p>5. Raskid ugovora o zakupu takođe vrši zakupac, uz obaveštenje trideset (30) dana unapred.</p> <p>6. Zakupac ima obavezu da pre raskida ugovora izmiri svaku obavezu iz korišćenja stambene jedinice i pratećih usluga.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Kufizimi dhe transferimi i të drejtës të banimit social</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Restriction and transfer of the right of social housing</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Ograničenje i prenos prava na socijalno stanovanje</b></p>
<p>1. Njësia e banimit social, e dhënë me qira nuk mund të shitet, të nënkontraktohet apo të tjetërsohet në çfarëdo mënyre, nga përfituesi.</p> <p>2. Në rast të vdekjes së kryefamiljarit përfituesit që ka anëtarë të familjes, ose anëtar i cili është nënshkruesi i kontratës për banim social, të drejtat dhe detyrimet nga kjo kontratë</p>	<p>1. The rented social housing unit cannot be sold, subcontracted or alienated in any way by the beneficiary.</p> <p>2. In case of the death of the head of the family of the beneficiary who has it family members, or a member who is the signatory of the contract for social housing, the rights and</p>	<p>1. Iznajmljenu jedinicu socijalnog stanovanja korisnik ne može prodati, podugovarati ili otuđiti na bilo koji način.</p> <p>2. U slučaju smrti nosioca porodice korisnika koji ima članove porodice, odnosno člana koji je potpisnik ugovora o socijalnom stanovanju, prava i obaveze iz ovog ugovora prelaze na</p>

